



Departamenti i Prokurimit

Prishtine : datë, 27.07.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 23.07.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “AC ING SHPK”&AAG Projekt SHPK lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndertimi i Qendres Kulturore per te rinjet-Bibliotekes ne Kodren e Trimave”, me Nr. të Prok: 616 19 9417 511 nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik të “AC ING SHPK”&AAG Projekt SHPK” e dates 23.07.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndertimi i Qendres Kulturore per te rinjet-Bibliotekes ne Kodren e Trimave”, me Nr. të Prok: 616 19 9417 511 kundër Njoftimit te AK –së, të datës 20.07.2020 te publikuar ne web-faqe te KRPP-së .
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit sipas Vendimit te dates 20.07.2020
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik”AC ING SHPK”&AAG Projekt SHPK”me daten 23.07.2020 ka parashtruar kerkesen per rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndertimi i Qendres Kulturore per te rinjet-Bibliotekes ne Kodren e Trimave”, me Numer të Prokurimit: 616 19 9417 511.

Autoriteti Kontraktues, me datë 27.07.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

-Lidhur me pretendimin numer 1 se nje anetar i konzorciumit ka dorezuar deshmine se eshte ne marreveshje me ATK-ne lidhur me pagesat e borxheve ndaj te njejtës ua perkujtojmë se ATK-

ja eshte organ kompetent per te verifikuar kryerjen e obligimeve te OE-ik dhe per AK-ne eshte me rendesi qe te verifikohet Deklarata nen betim dhe se nuk eshte pergjegjesi e AK-se te kerkoje datat e marreveshjeve per te cilat eshte kompetent nje Institucion tjeter-ATK-ja;

-Lidhur me pretendimin 2 ju sqarojme se ceshtja e nenshkrimet te marreveshjes dhe dokumenteve te tenderit nuk eshte e rregulluar ne menyre decidive dhe se ato dokumente sigurisht se ne mungese te personit te autorizuar apo ne marreveshje me te njejtin i nenshkruan ndonje anetar i personelit dhe nese nuk ka autorizim kjo nuk paraqet asnje shmangje substanciale qe do te mund ta trajtonte nje tenderues si te pa pergjegjshem;

-Lidhur me pretendimin numer 3 qe ka te beje me referencat ju sqarojme se tenderuesi i propozuar tani per dhenje te kontrates nga AK-ja eshte shpalle i pa pergjegjshem, mirepo OSHP-ja ka konsideruar se eshte dashte te pranohen edhe referencat nga renovimet e objekteve dhe AK-ja detyrimisht duhet ta zbatoj kete rekomandim. Ua perkujtoj se ketu kemi permendur rastin kur ka dallime ne mes te opinionit te AKK-se dhe Vendimit te OSHP-se, por ne nuk jemi ne dijeni se lidhur me rastin konkret ka ndonje opinion te AKK-se, por ka vetem nje Vendim te OSHP-se dhe sipas te cilit pala e pakenaqur ka te drejte qe brenda afatit prej 30 ditesh te parashtroj ankese ne Gjykate;

-Pretendimet tuaja lidhur me stafin e Grupit te OE-ik te propozuar per dhenje te kontrates, mungesen e pervojes per ndertim te larte, mungesen e ndonje nenshkrimi te anetareve te grupit e ndonje devijim tjeter i vogel ju sqarojme se nuk jane devijime substanciale dhe nuk jane baze per te trajtuar nje tender si te pa pergjegjshem e aq me pak kur sipas Vendimit te OSHP-se trajtohet si i pergjegjshem;

-Pretendimet se eksperti shqyrtues ka vepruar pa te drejte me rastin e ekspertizes ju sqaroj se lidhur me kete kompetent per te vleresuar ate veprim eshte Paneli Shqyrtues i OSHP-se e jo AK-ja; dhe

-Pretendimi juaj se AK-ja ka bere vleresim te ngutshem dhe ne kundershtrim me kerkesat e FDT-se nuk ka baze per arsyen e thjeshte se nje organ meritor OSHP-ja ka konstatuar se referencat qe ne i kemi trajtuar si te pa pranueshme duhet te jene te pranueshme dhe bazuar ne kete eshte marre Vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit